

Sekuestrohen tri revole dhe 51 fishekë, policia tregon detajet



14/03/2024 09:00



Njësia e Drejtorisë për Hetimin e Krimit të Organizuar ka zhvilluar një aksion për shitje të paautorizuar të armëve në katër lokacione.

Gjatë aksionit policia ka arritur të sekuestrojë tri revole dhe 51 fishekë, ndërsa me urdhër të prokurorit katër të dyshuar janë liruar në procedurë të rregullt.

“Lidhur me rastin, më 13.03.2024 Njësitë e Drejtorisë për Hetimin e Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda të Policisë së Kosovës bazuar në urdhëresën e Gjykatës kanë bërë kontrollimin e shtëpive me objektet përcjellëse, në katër (4) lokacione, në tri rajone, Prishtinë, Pejë, Prizren. Gjatë kontrollit të shtëpive dhe objektet përcjellëse janë gjetur dhe sekuestruar: tri revole dhe 51 fishekë. Me urdhër të prokurorit katër të dyshuar meshkuj/k, pas intervistimit, janë liruar në procedurë të rregullt.” [/Lajmi.net/](#)

Më shumë nga uebi

nativeGRAM
by LupaMedia



Artikuj të ngjashëm



March 14, 2024
Qeveria Kurti i dha tokën Manastirit të Deçanit, Zemaj: Nuk garanton...



March 14, 2024
Haradinaj shtron iftar: Marrin pjesë edhe nga Bashkësinë Islame e Kosovës



March 14, 2024
Djali i vdiq prej drogave: Ajo gjeti forcë që ta hap...



March 14, 2024
Kosova dhe Britania me bashkëpunim ushtarak të shtuar: FSK do të...



March 14, 2024
Vendosen shenjat zyrtare të vendbanimeve konform ligjeve të Kosovës në veri



March 14, 2024
Përfundon takimi, Escobar: Kurti më premtoi se do të marrë parasysh...



info@lajmi.net
Tel: +383 49 131 131
Rr. Zenel Salihu nr. 28, zyrra nr. 5

RRJETET SOCIALE



Other Links

Fact-Checking Policy
Ethics Policy
Corrections Policy
Ownership & Funding Information
Editorial Team Information